



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 441/5 prot.
2023

Tiranë, më 21. 11.

V E N D I M

Nr. 237, datë 21. 11. 2023

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në ligjin 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar,² shqyrtoi ankesën nr. 197, datë 15.12.2022, të paraqitur nga Fondacioni “Së Bashku”³, përfaqësuar nga S. L., Drejtore Ekzekutive, kundër Bashkisë Kavajë, me pretendimin për diskriminim të personave me aftësi të kufizuara, lidhur me garantimin e vendeve të parkimit të rezervuara për personat me aftësi të kufizuara.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit pala ankuese shpjegon se, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj në mbrojtje të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara është informuar se në Bashkinë Kavajë janë konstatuar problematika për garantimin e vendparkimeve të rezervuara për personat me aftësi të kufizuara.

Bazuar në informacionin e paraqitur nga pala ankuese, kjo e fundit parashtron se, në të gjitha rrugët dhe sheshet ku është e mundur parkimi i makinave, nuk ka asnjë vend të vetëm parkimi për personat me aftësi të kufizuara, duke krijuar kështu vështirësi për personat me aftësi të kufizuara për të dalë dhe për të marrë shërbime në të gjithë këtë bashki.

Sa më sipër, pala ankuese kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara nga ana e Bashkisë Kavajë.

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

³ Në vijim do t'i referohemi me “Pala ankuese”

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, shkronja “b”, të LMD, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat e paraqitura nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm, për çështje që lidhen me interesa kolektive.

Bazuar në dispozitën e mësipërme ligjore rezulton se, kërkesën për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit mund t’ja bëjë edhe një palë e cila nuk pretendon diskriminim në emrin e vet, pra që nuk ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë të vetin. Në këtë rast që kjo palë të legjitimohet për të bërë ankesë dhe për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit, duhet të provojë se është mbajtëse e interesave kolektive, të cilat mund të cënohen nga procedura konkrete administrative. Një palë e tillë duhet të provojë lidhjen e detyrueshme, të drejtpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë që ajo kryen dhe çështjes së paraqitur pranë Komisionerit.

Bazuar në nenin 3, pika 11, të LMD, përcaktohet se: *“Organizatat me interesa legjitime” janë ato organizata, të cilat janë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë dhe kanë si objekt të deklaruar të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ose u ofrojnë ndihmë viktimave të diskriminimit”*.

Nga aktet e administruara rezulton se, Fondacioni “Së Bashku” është një organizatë jofitimprurëse, regjistruar si person juridik, me vendimi nr. 427, datë 18.06.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Bazuar në ankesën e paraqitur Fondacioni “Së Bashku” nuk pretendon se është cënuar në interesin e tij të ligjshëm dhe të drejtpërdrejtë, por pretendon diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara që përfitojnë shërbimet në Bashkinë Kavajë. Bazuar në statutin dhe aktin e themelimit, Fondacioni “Së Bashku”, është një organizatë jofitimprurëse e krijuar, me qëllimin që t’ju përgjigjet nevojave të grupeve të përjashtuara në Shqipëri, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se provohet lidhja e detyrueshme, e drejtpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë së ankuesit dhe çështjes që kjo organizatë ka paraqitur, duke vlerësuar përfundimisht se ankuesi legjitimohet para Komisionerit për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi.

Bazuar në nenin 7 të LMD, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të LMD-së dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të LMD. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të LMD, Komisioneri shqyrtoi çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Njëpërmjet shkresës me Nr. 1600/1 prot., datë 20.12.2022, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion Bashkisë Kavajë, lidhur me pretendimet e subjektit ankues.

Bashkia Kavajë, pavarësisht faktit që mori informacion, lidhur me shkresën e sipërcituar, nuk depozitoi asnjë dokument apo parashtrim lidhur me sa ka kërkuar Komisioneri në kuadër të shqyrtimit të ankesës në fjalë.

2. Sa më sipër, Komisioneri me anë të shkresës Nr. 249 prot., datë 10.02.2023, iu drejtua sërish Bashkisë Kavajë, duke i kërkuar informacion lidhur me pretendimet e subjektit ankues.

Në përgjigje sa më sipër, Bashkia Kavajë me anë të shkresës⁴ Nr. 645/1 prot., datë 17.02.2023, informoi se Drejtoria e Shërbimeve Publike në Bashkinë Kavajë ka filluar procedurat për tenderimin mbi sinjalistikën rrugore të qytetit të Kavajës, si dhe të sinjalistikën e vendparkimeve për personat me aftësi të kufizuara, të cilat do të vendosen në rrugët dhe sheshet ku është i mundur parkimi i automjeteve.

3. Lidhur me gjykimin me objektivitet të çështjes, njëpërmjet e-mail-it datë 27.02.2023, Komisioneri iu drejtua palës ankuese dhe i përcolli për dijeni korrespondencën e mbajtur me Bashkinë Kavajë, si dhe një kopje të Buletinit të Njoftimeve Publike Nr. 17, datë 20.02.2023.

Në përgjigje sa më sipër, Fondacioni “Së Bashku”, vlerësoi angazhimin e Bashkisë Kavajë sa i përket garantimit të vendeve të parkimit, si dhe sqaroi se i duhet lënë kohë deri në marrjen e informacionit për vendndodhjen e tyre dhe numrin, i cili duhet të jetë në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1503, datë 19.11.2008 *“Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”*.

4. Me anë të shkresës Nr. 249/2 prot., datë 23.03.2023, Komisioneri iu drejtua sërish Bashkisë Kavajë dhe kërkoi që në momentin e përfundimit të punimeve për caktimin e vendparkimeve, për personat me aftësi të kufizuara, të vërë në dispozicion:

- Kopje të dokumentacionit të marrjes në dorëzim apo përfundimin të punimeve për caktimin e vendparkimeve, për personat me aftësi të kufizuara, të cilat përcaktohen mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1503, datë 19.11 .2008 *“Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”*;
- Foto të realizuara ose projekti i caktimit të vendparkimeve, për personat me aftësi të kufizuara;

⁴ Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 1203/5 prot., datë 17.10.2022

Lidhur me sa më sipër, Komisioneri vlerësoi se, informacioni i kërkuar më sipër për garantimin e vendparkimeve të rezervuara për personat me aftësi të kufizuara nga ana e Bashkisë Kavajë, është i domosdoshëm për marrjen e një vendimi përfundimtar për çështjen.

Bazuar në nenin 85/3 të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se: “3. Në ato raste kur informacioni apo dokumentet e kërkuara nga palët janë të domosdoshme për shqyrtimin e pretendimit të ngritur nga vetë palët, procedura pezullohet deri në sigurimin e informacionit dhe palët njoftohen për këtë gjë”.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, arriti në përfundimin se, procedurat për shqyrtimin e ankesës Nr. 197 Regj., datë 15.12.2022, së Fondacionit “Së Bashku”, duhet të pezullohen deri në sigurimin e informacionit të kërkuar nga ana e Bashkia Kavajë. Për këtë me vendimin Nr. 46, datë 27.03.2023, vendosi pezullimin e procedurës administrative, lidhur me shqyrtimin e ankesës Nr. 197 Regj., datë 15.12.2022, të Fondacionit “Së Bashku”, deri në sigurimin e informacionit të kërkuar.

5. Në vijim, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me shkresën Nr. 441/2 prot., datë 11.07.2023 iu drejtua sërish Bashkisë Kavajë, me një kërkesë të përsëritur për informacion dhe dokumentacion në lidhje me çështjen, si më poshtë:

- Kopje të dokumentacionit të marrjes në dorëzim apo përfundimin e punimeve për garantimin e vendeve të parkimeve për personat me aftësi të kufizuara, në qytetin e Kavajës;
- Foto të realizuara në të cilat të evidentohet garantimi i vendeve të parkimeve për personat me aftësi të kufizuara, në qytetin e Kavajës;

Bashkia Kavajë ka marrë dijeni për shkresën Nr. 441/2 prot., datë 11.07.2023, më datën 13.07.2023, fakt ky që rezulton i provuar nga lajmërim marrja e shërbimit postar Nr. RR 443 666 313 AA administruar në dosje, por nuk ka kthyer përgjigje.

6. Me datë 06.09.2023, Komisioneri iu drejtua sërish Bashkisë Kavajë, duke kontaktuar me anë të e-mail-it⁵ me Sekretarin e Përgjithshëm të këtij institucioni, A. C., si dhe sjellë në vëmendje të tij faktin e moskthimit të një përgjigje zyrtare kërkesave të përsëritura.

Pavarësisht sa më sipër, nga ana e Bashkisë Kavajë nuk u vu në dispozicion të Komisionerit asnjë informacion lidhur me çështjen.

Në këto kushte, referuar faktit që nga ana e Bashkisë Kavajë nuk u vu në dispozicion asnjë informacion lidhur me hapat e ndërmarrë sa i përket garantimit të vendeve të parkimit për personat me aftësi të kufizuara, në qytetin e Kavajës, si dhe faktit që kishte përfunduar afati për dhënien e një vendimi përfundimtar, Komisioneri çmoi se duhej vijuar me çeljen e procedurës së

⁵ Referuar një kopje e tij në dosje.

shqyrtimit të ankesës. Sakaq me Vendimin Nr. 236, datë 20.11.2023, Komisioneri vendosi ndërprerjen e pezullimit dhe çeljen e procedurës administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 197, datë 15.12.2022, të Fondacionit “Së Bashku”.

III. Vlerësimi i fakteve nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë.

Komisioneri ka shqyrtuar çështjen bazuar në situatën e konstatuar, provat dhe informacionin e administruar gjatë procedurës administrative të zhvilluar.

Pala ankuese në çështjen në objekt shqyrtimi është një organizatë jofitimprurëse, e cila ushtron veprimtarinë e saj ndër të tjera në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Pala ankuese pretendon se në territorin e Bashkisë Kavajë ku është i mundur parkimi i makinave, nuk ka asnjë vend parkimi për personat me aftësi të kufizuara. Sipas palës ankuese, një situatë e tillë diskriminon personat me aftësi të kufizuara të cilët për shkak të mungesës së vendeve të parkimit, nuk mund të marrin në mënyrë të lirë dhe të pavarur shërbimet e tyre në territorin e administruar nga Bashkia Kavajë.

Për të marrë informacion dhe për të shqyrtuar pretendimet e ngritura nga pala ankuese, Komisioneri i’u drejtua Bashkisë Kavajë, në cilësinë e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa objekt shqyrtimi, duke kërkuar informacion nëse kjo bashki garantonte vendet e parkimit të rezervuara për personat me aftësi të kufizuara, konform parashikimeve ligjore në fuqi.

Referuar shkresës⁶ Nr. 645/1 prot., datë 17.02.2023, të Bashkisë Kavajë, Komisioneri u informua se Drejtoria e Shërbimeve Publike në Bashkinë Kavajë ka filluar procedurat për tenderimin mbi sinjalistikën rrugore të qytetit të Kavajës, si dhe të sinjalistikën e vendparkimeve për personat me aftësi të kufizuara, të cilat do të vendosen në rrugët dhe sheshet ku është i mundur parkimi i automjeteve. Në këtë kuptim, Bashkia Kavajë deri në momentin e paraqitjes së ankesës pranë Komisionerit, pranoi se nuk ka marrë masa për garantimin e hapësirave të parkimit/vendparkimit për personat me aftësi të kufizuara sipas kërkesave të parashikuara nga Vendimi Nr. 1503, datë 19.11.2008 i Këshillit të Ministrave “*Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”*” (në vijim VKM nr. 1503/2008). Pavarësisht faktit që nga ana e saj, Bashkia Kavajë informoi dhe nisi procedurat për tenderimin mbi sinjalistikën rrugore të qytetit të Kavajës, si dhe sinjalistikën e vendparkimeve për personat me aftësi të kufizuara, nuk vuri në vijim asnjë informacion lidhur me përfundimin e punimeve apo plotësimin e kërkesave të subjektit ankues edhe pse nga Komisioneri iu kërkua në mënyrë të përsëritur.

Bashkia Kavajë, me gjithë kërkesat e përsëritura të Komisionerit, nuk dërgoi asnjë dokumentacion apo informacion të detajuar në lidhje me përmbushjen e kritereve dhe

⁶ Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 1203/5 prot., datë 17.10.2022

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

parashikimeve në lidhje me sigurimin e parkimeve për personat me aftësi të kufizuara të parashikuara nga VKM-të nr. 1503/2008 dhe nr. 1074, datë 23.12.2015, apo ndonjë planifikim për plotësimin e tyre në të ardhmen.

Kuadri ligjor i zbatueshëm.

Neni 23, i Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, parashikon funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike. Në këtë nen parashikohet se:

“Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për:

1. *Prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm.*
2. *Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura.*
3. *Mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut dhe mbrojtjen nga përmytjet në zonat e banuara.*
4. *Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore.*
5. *Ndriçimin e mjediseve publike;*
6. *Transportin publik vendor.*
7. *Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike, si dhe garantimin e shërbimit publik të varrimit.*
8. *Shërbimin e dekorit publik.*
9. *Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike.*
10. *Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake.*
11. *Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale.*
12. *Administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe.*
13. *Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor dhe zhvillimin e aktiviteteve edukuese e promovuese në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e shëndetit, si dhe administrimin e qendrave e të shërbimeve të tjera në fushën e shëndetit publik, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.*
14. *Planifikimin, administrimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.”*

Neni 29, pika 4 e Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, parashikon funksionet e bashkive në fushën e sigurisë publike. Në këtë nen parashikohet se: *“Bashkitë janë përgjegjëse për garantimin e këtyre funksioneve: 4. Parandalimin e kundërvajtjeve administrative, forcimin, inspektimin dhe monitorimin e zbatimit të rregulloreve e të akteve të njëjësive të vetëqeverisjes vendore brenda juridiksionit të tyre vendor dhe në përputhje me përcaktimet ligjore”.*

Në Ligjin nr. 8378/1998 “Kodi Rrugor i republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet se:

“Neni 7; Rregullimi i qarkullimit në qendrat e banuara, pika 1: Në qendrat e banuara, bashkitë, me urdhëresë të kryetarit të pushtetit lokal, duhet:..... d) të rezervojë hapësira të caktuara për qëndrimin e mjeteve të organeve të policisë rrugore sipas nenit 12, të zjarrfikëseve, të shërbimit të ndihmës së shpejtë dhe të atyre në shërbim të personave me aftësi të kufizuara lëvizëse, të pajisura me shenja speciale, ose për mjetet e shërbimit në linjë për qëndrimin e tyre në stacionet fundore të linjave;;

Neni 12; Kryerja e shërbimeve të policisë rrugore dhe e kontrolleve të tjera në rrugë, pika 1: Kryerja e shërbimeve të policisë rrugore të përcaktuara nga ky Kod i takon: c) policisë së bashkisë, në bashkitë me popullsi më të madhe se 20 000 banorë, për territorin në juridiksion, vetëm për shkeljet që kanë të bëjnë me parkimet, të kryera në rrugët që janë në administrim/pronë të bashkisë, të parashikuara në nenin 7, me përjashtim të pikës 12 të tij, nenin 11 pika 1 shkronjat “a” dhe “e”, nenin 85, 86, 87, 89, 155 pika 6, 156 pika 1 shkronjat “g” dhe “h”, pika 2 shkronjat “d”, “e”, “g”, “h”, “i”, “j”, “k” dhe “l”;

Neni 186; Qarkullimi dhe pushimi i mjeteve në shërbim të invalidëve, pika 1: Për qarkullimin dhe pushimin e mjeteve në shërbim të invalidëve, entet pronare të rrugës janë të detyruara të ndërtojnë dhe mirëmbajnë strukturat përkatëse, si dhe sinjalizimin e nevojshëm për të lejuar e lehtësuar lëvizjen e tyre, siç është përcaktuar në aktet në zbatim”.

Për sa më sipër, rezulton se Bashkia Kavajë është autoriteti përgjegjës në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, në territorin e juridiksionit të saj. Përgjegjësitë e saj lidhen me sigurimin e parkimeve për personat me aftësi të kufizuar, sigurimin e sinjalistikës rrugore për këto parkime dhe sigurimin e mos zënies së këtyre parkimeve nga përdorues të tjerë.

Me ligjin nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”⁷, Shqipëria ka ratifikuar Konventën e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”⁸. Bazuar në nenin 116, të Kushtetutës, ky akt ndërkombëtar i të drejtave të njeriut jo vetëm që bëhet pjesë e të drejtës së brendshme e detyrueshme për t’u zbatuar, por duke patur edhe përparësi ndaj ligjeve të tjera.

KDPAK përfaqëson standardin më të lartë të mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Qëllimi i kësaj Konvente është të promovojë, mbrojë dhe sigurojë që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të promovojë respektin e dinjitetin e tyre të lindur (neni 1).

Konventa nuk jep një përkufizim të aftësisë së kufizuar, por pranon se aftësia e kufizuar është një koncept evolues dhe se aftësia e kufizuar rezulton nga ndërveprimi ndërmjet personave me dëmtime dhe barrierave/pengesave të qëndrimit/mentalitetit dhe ambientit që pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në nivel të barabartë me të tjerët (Preambula e KDPAK,

⁷ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KDPAK.

⁸ Ratifikuar me ligjin nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”.

germa “e”). Rrjedhimisht në qendër të vëmendjes nuk duhet të jetë paaftësia/paaftësitë e mundshme, por kufijtë që ngre shoqëria, duke penguar gëzimin e të drejtave. Nga ana tjetër KDPAK pranon diversitetin e personave me aftësi të kufizuara.

Me qëllim që të bëhet e mundur që të gjithë personat me aftësi të kufizuara të mund jetojnë në mënyrë të pavarur dhe të marrin pjesë plotësisht në të gjitha aspektet e jetës, shtetet duhet të marrin masat e duhura për të siguruar akses për personat me aftësi të kufizuara, në baza të barabarta me të tjerët, në ambientet fizike, transport, informacion dhe komunikim, përfshirë dhe teknologjitë dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit, si dhe në mjete apo shërbime të tjera të hapura apo të siguruar për publikun, si në zonat urbane dhe ato rurale. Këto masa, të cilat duhet të përfshijnë identifikimin dhe eliminimin e pengesave dhe barrierave për mundësimin, zbatohen ndër të tjera për: a) ndërtesa, rrugë, transport dhe mjete të tjera në ambiente të brendshme apo të jashtme, përfshirë shkollat, strehimin, shërbime mjekësore apo vendet e punës; (neni 9/1 KDPAK).

Aksesueshmëria ose e thënë ndryshe heqja e pengesave/barrierave, është një parakusht që personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në baza të barabarta me të tjerët në shoqëri, për të jetuar në mënyrë të pavarur, për të gëzuar gjithë të drejtat dhe liritë e parashikuara. Për rrjedhojë, aksesueshmëria është ngushtësisht e lidhur me barazinë dhe mosdiskriminimin e personave me aftësi të kufizuara. Aksesueshmëria duhet të sigurohet për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, pavarësisht nga lloji i aftësisë së kufizuar. Për rëndësinë që aksesueshmëria paraqet, parashikohet nga KDPAK si një e drejtë më vete në nenin 9, por edhe si një nga parimet themelore që përshkon të gjithë Konventën, sipas nenit 3.

Në pikën 2, të nenit 9, të KDPAK, parashikohet se: “2. Shtetet palë duhet gjithashtu të marrin masat e duhura: a) për të zhvilluar, shpallur dhe monitoruar implementimin e udhëzimeve dhe standardeve minimale për mundësimin e mjeteve dhe shërbimeve të hapura apo të siguruar për publikun;....”

Në frymën e Konventës, është miratuar, ligji 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara” (në vijim ligji nr. 93/2014). Në nenin 3, pika 9, të ligjit të sipërcituar, përcaktohet se: “9. “Persona me aftësi të kufizuara” janë individët që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, dëmtime të cilat, në bashkëveprim me pengesat e ndryshme, përfshirë ato mjedisore dhe të qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efikase të këtyre personave në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët”.

Në nenin 3, pika 1, të ligjit nr. 93/2014, përcaktohet: “Aksesueshmëri” është mënjanimi i pengesave të të gjitha llojeve”. Më tej në pikën 3, të këtij neni parashikohet se: “3. “Pengesat” nënkupton: a) pengesat sociale, veçanërisht qëndrimet, stereotipet e sjelljen tutelore; b) pengesat mjedisore, përfshirë vështirësitë në komunikim që kanë personat me dëmtime ndijore, veçanërisht ata me dëmtime në shikim dhe dëgjim, ata për të cilët komunikimi verbal është i kufizuar ose i pamundur e personat që kërkojnë formate të thjeshta për t’u lexuar dhe për t’u kuptuar; c) pengesat infrastruktorore, përfshirë ato në banesa, hapësira dhe shërbime publike; ç) pengesat institucionale, përfshirë ato në legjislacion dhe politika”.

Në përputhje me qasjen e KDPAK edhe ky ligj sanksionon se aksesueshmëria është një nga parimet e këtij ligji (neni 4/ç) dhe se jetesa e pavarur e personave me aftësi të kufizuara mund të sigurohet nëpërmjet garantimit të aksesueshmërisë, ndër të tjera nëpërmjet pjesëmarrjes në të gjitha sferat e jetës, përfshirë jetën komunitare dhe qytetare (neni 5/1⁹).

Për mënjanimin e pengesave mjedisore dhe infrastrukturore, Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara” (në vijim VKM nr. 1074/2015). Ky vendim përcakton masat për zbatimin dhe unifikimin e rregullave, në bazë të të cilave mënjanohe pengesat mjedisore dhe infrastrukturore për të bërë të mundur aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime për personat me aftësi të kufizuara. Sipas këtij vendimi, janë pengesa infrastrukturore: a) pengesat fizike si burim vështirësish për lëvizjen e kujtudo dhe në mënyrë të veçantë të atyre që, për çfarëdolloj arsyeje, kanë një aftësi lëvizëse të kufizuar, të përhershme ose të përkohshme; b) pengesat që kufizojnë ose pengojnë këdo në përdorimin komod dhe të sigurt të hapësirave, pajisjeve e të pjesëve përbërëse; c) mungesa e mjeteve dhe e sinjalizimeve që lejojnë orientimin dhe njohjen e vendeve e të burimeve të rrezikut për këdo dhe, në veçanti, për personat me shikim apo dëgjim të kufizuar (Kreu I, pika 3). Ky vendim është i detyrueshëm si ndaj sektorit publik ashtu edhe atij privat dhe përfshin të gjitha ndërtesat e reja ashtu edhe ato ekzistuese, e në mënyrë të veçantë ato mjedise ku ofrohen shërbime publike, parqet, sheshet e rrugët (Kreu I, pika 4).

Sipas pikës 2, të kreut 2, të kësaj VKM-je, çdo kërkesë teknike për përshtatshmërinë e objekteve të reja dhe atyre ekzistuese, parqeve, shesheve dhe rrugëve zbatohet sipas dispozitave të parashikuara në vendimin nr. 1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara” (në vijim VKM nr. 1503/2008). Ndër të tjera, në këtë rregullore parashikohet sa më poshtë vijon:

“PJESA I

Zbatimi i rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike.

Kreu I

Të përgjithshme

Neni 1

Objekti, qëllimi dhe fusha e aplikimit

- 1. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave teknike për eliminimin e pengesave që përcaktohen si “barriera arkitektonike”.*

⁹ “Jetesa e pavarur u siguron personave me aftësi të kufizuara zgjedhje, kontroll dhe liri të njëjta me të tjerët, kur është nevoja, nëpërmjet ofrimit të mbështetjes dhe të ndihmës, bazuar në zgjedhjen dhe aspiratat e vetë individit për nevojat e jetës së përditshme, përfshirë aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime e mundësi të tjera, si dhe nëpërmjet pjesëmarrjes në të gjitha sferat e jetës, përfshirë jetën familjare, komunitare dhe qytetare”.

2. *Kjo rregullore ka për qëllim zbatimin e rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike.*
3. *Fusha e aplikimit të saj shtrihet në:*
 - *të gjitha objektet publike të reja të ndërtuara me fondet e buxhetit të shtetit apo private si dhe në objektet private, që ndërtohen në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;*
 - *godinat dhe hapësirat publike, ndërtimet e reja me karakter të përkohshëm, ose në ato ekzistuese nëse do t'i nënshtrohen rikonstruksionit;*
 - *ndërtesat dhe hapësirat publike që i nënshtrohen çfarëdolloj ndërhyrjeje ndërtimi që ka të bëjë me heqjen e kufizimit të mundësisë së pamjes dhe fushëpamjes, që të paktën, qoftë edhe pjesërisht, është pjesë e ndërhyrjes;*
 - *ndërtesat dhe hapësirat publike që janë, tërësisht ose pjesërisht, objekt i ndryshimit të destinacionit nëse do të jetë në përdorim publik, si edhe për shërbime të veçanta për përdorim publik.*

Neni 2

Përshtatja e objekteve ekzistuese

1. *Në ndërtesat dhe hapësirat publike ekzistuese, edhe pse nuk janë objekt ristrukturimi ose riorganizimi funksional, duhet të evidentohen dhe të llogariten të gjitha mundësitë për përshtatje, të cilat mund të përmirësojnë shfrytëzimin në bazë të kërkesave që janë në këtë rregullore.*
2. *Çdo ndërtesë duhet të pajiset, nën kujdesin e administratorit publik apo privat të ndërtesës, me një sistem thirrjesh që të aktivizojë një shërbim ndihme në mënyrë të tillë që t'u lejojë personave me aftësi të kufizuara lëvizjen ose ndijimin e shërbimit me zë.*
3. *Në objektet e banimit publike/private dhe në banesa vetjake, përfshi edhe ato të hapura për publikun, aplikohen rregullat dhe standardet e përcaktuara në këtë rregullore.*
4. *Nuk mund të ofrohen kontribute ose lehtësime nga ana e shtetit dhe e enteve të tjera publike për realizimin e punimeve publike ose të shërbimeve publike në kundërshtim me këto rregulla dhe standarde.*
8. *Eliminimi i barrierave - është rezultat i aplikimit të zgjedhjes teknike në projektim dhe ndërtim të objektit me të cilat PAK-ja siguron lëvizjen pa pengesë, qëndrimin dhe kryerjen e punëve në to në të njëjtin nivel sikurse personat e tjerë.*
9. *Elementet e eliminimit të barrierave - janë pjesë të objekteve ndërtimor ose pajisje, të cilat sigurojnë eliminimin e barrierave, të përcaktuara me këtë rregullore. Këto elemente ose pajisje janë: rampa, shkallë, ashensor, platforma vertikale ngritëse, platforma të pjerrëta lëvizëse palosëse, detaje në hapësirat hyrëse, doreza e derës dhe dritares, pulti, tabela e shpalljeve, plani orientues për lëvizje në ndërtesë, semafori, pajisje komunikimi, hapësira dhe pajisje ËC, banja, kuzhine, dhoma, klasa, ambiente pune, banimi/apartamenti, kafeneja, restoranti, gardëroba, kabina dushi, pishina, vendet në tribuna, kabina telefonike, tekstofoni, bankomati, instalimet elektrike, stacioni dhe peroni, vend parkingu, sipërfaqja publike për këmbësor, kalimi për këmbësor, ishulli për këmbësorë dhe udhëkryqi.*

Në nenet 12 dhe 13, të pjesës së parë të rregullores, për parkimet parashikohet se:

“Neni 12, Parkimet;

1. Për parkimet vlejné rregullat e dhëna në pikën 2.3 të nenit 4 dhe standardet e dhëna në pikën 3.3 të nenit 8 të pjesës së dytë të kësaj rregulloreje.
2. Për vendet e rezervuara të vendosura paralelisht me drejtimin e lëvizjes, gjerësia duhet të jetë e tillë që të lejoj kalimin e një personi në karrige me rrota në mes të dy makinave. Kjo kërkesë është e plotësuar nëse gjatësia e vendit të makinës nuk është më e vogël se 6 m. Në një rast të tillë, gjerësia e një vendi të rezervuar për makinë nuk tejkalon gjatësinë e një vendi të zakonshëm për makinë (250 cm).
3. Vendet e rezervuara mund të kufizohen me vendosjen e mjeteve bllokuese të posaçme.

Neni 13, Qarkullimi dhe qëndrimi i mjeteve në shërbim të personave me aftësi të kufizuar

1. Personat mbajtës të shenjave dalluese, të klasifikuar sipas nenit 14 të pjesës së parë të kësaj rregulloreje, u lejohet nga autoritetet kompetente, qarkullimi dhe qëndrimi i mjetit në shërbim të tyre:
 - në vendet që nuk përbëjnë pengesë për trafikun;
 - në raste të ndërprerjes ose kufizimit të qarkullimit për motive të sigurisë publike;
 - në raste të ndërprerjes ose kufizimit të qarkullimit për interesa publike ose për nevoja me karakter ushtarak;
 - kur janë vendosur kushte ose ndalime të karakterit të përhershëm ose të përkohshëm;
 - kur ndalohet dhe kufizohet qëndrimi.
5. Në vendet e parkimeve ose vendet e qëndrimit, të pajisur me mekanizma të kontrollit të kohëzgjatjes së qëndrimit për ruajtjen e makinave, të paktën 1 në çdo 50 vende ose në fraksion të 50 vendeve të disponueshme duhet të jenë të rezervuara falas për personat mbajtës të shenjave dalluese.
6. Vendet e cituara në pikën 5 të këtij neni duhet të jenë të shënuara me shenjën e përkatëse të arritshmërisë.

Në nenin 4, të Kreut II, të pjesës së dytë, të VKM nr. 1503/2008, përcaktohen kriteret e projektimit për arritshmërinë:

“1.14 Garazhet, vendi i të cilave duhet të lidhet me hapësirat e jashtme dhe me pajisjet e ngritjes, të përshtatshme për përdorim nga personat në karrige me rrota.

Hapësira e rezervuar për ndalim qëndrimin e makinave në shërbim të personave me aftësi të kufizuara, duhet të ketë dimensione të tilla që të lejojë edhe lëvizjen e këtyre personave në kohën e hipjes në mjet. Ajo duhet bërë e dukshme nëpërmjet sinjaleve përkatëse horizontale dhe vertikale sipas standardeve të dhëna në pikën 2.14 të nenit 8 të pjesës së dytë të kësaj rregulloreje.

2.3 Parkimi konsiderohet i arritshëm nëse sipërfaqja në të cilën lëviz personi në karrigen me rrota është në të njëjtin plan me sipërfaqet e këmbësorëve të shërbimit ose lidhja midis tyre, në raste disnivelesh që kalojnë kufirin e lejuar, kryhet nëpërmjet platformave të pjerrëta ose të

pajisjeve të përshtatshme të ngjijtes, sipas standardeve të dhëna në pikën 3.3 të nenit 8 të pjesës së dytë të kësaj rregulloreje.

Hapësira e rezervuar e ndalimit të makinave të personave me aftësi të kufizuara duhet të ketë të njëjtat karakteristika si në pikën 1.14 të këtij neni.

3. Sinjalistika në ndërtesa dhe nëpër hapësirat e arritshme duhet të vendoset në mënyrë të dukshme që të shihen lehtësisht tabelat me udhëzime për orientimin dhe shfrytëzimin e hapësirave të ndërtuara, duke dhënë informacionin e duhura mbi mënyrën e hyrjes nga personat me aftësi të kufizuara ose paaftësi lëvizëse. Në raste të tilla tabelat treguese duhet të kenë edhe simbolin tregues ndërkombëtar të arritshmërisë, shtojca A”.

Në Kreun IV, të pjesës së dytë, të VKM nr. 1503/2008, përcaktohen standardet dhe zgjidhjet teknike të detyrueshme për t’u zbatuar me qëllim për të garantuar mundësinë e përdorimit të hapësirave të jashtme nga ana e personave me aftësi të kufizuara. Konkretisht në nenin 8, të VKM së sipërcituar, përcaktohen në mënyrë të detajuar standardet funksionale dhe të përmasave në hapësirat e jashtme, të detyrueshme për t’u respektuar. Kështu në pikën 3.3 përcaktohet:

“Kreu IV, Standardet dhe zgjidhjet teknike.

3. Hapësirat e jashtme.

3.3 Parkimet duhet të vendosen në masën minimale 1 në çdo 50 vende makinash, me gjerësi jo më të vogël se 320 cm dhe e rezervuar falas për makinat e personave me aftësi të kufizuara. Të ashtuquajtura vende makinash, të sinjalizuara, caktohen në ngjitje të vendkalimeve të këmbësorëve dhe në afërsi të hyrjes së ndërtesave ose pajisjeve. Me qëllim lehtësimin e transferimit të personit në karrige me rrota në kushte të njëjta atmosferike, preferohet që vendet e makinave të rezervuara të jenë të pajisura me mbulesë. Vendparkimi për PAK duhet të vendoset afër hyrjes së ndërtesës. Vendparkimi për automjete, kur parkimi bëhet pjerrtas apo për së gjati në raport me trotuarin për këmbësorët, madhësia e tij duhet të jetë 370 x 500 cm, figura 32 shtojca B. Nëse vendparkimi është për dy makina madhësia e tij duhet të jetë 590 x 500 cm me distancë ndërmjet tyre 150 cm, figura 33, shtojca B. Dalja nga vendparkimi dhe hyrja në trotuaret e këmbësorëve kryhet me një pjerrësi 10% dhe gjerësi 120 cm”.

Në nenin 26, të Kreut V, të pjesës së dytë, të VKM nr. 1503/2008, përcaktohet se: *“Në parkimet dhe garazhet publike, si dhe pranë objekteve ndërtimore 5% e vendeve përshtaten në raport me numrin total të vend parkimeve, por jo me pak se një”.*

Në figurën 3, të shtojcës A, të pjesës së dytë, të VKM nr. 1503/2008, ilustruhet me figurë (1.25) shenja e parkingut të përshtatur për personat me AK, ndërsa në figurat 32 dhe 33 të shtojcës B, ilustruhet vendet e parkimit në varg dhe me hapësirë në mes, për personat me AK.

Referuar parashikimeve të mësipërme të bëra në VKM nr. 1503/2008, ekzistojnë rregulla dhe standarde të mirëpërcaktuara dhe të detyrueshme për zbatim, që duhet të përmbushin parkimet për personat me aftësi të kufizuar, për të eliminuar pengesat/barrierat dhe për të garantuar aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara.

Gjatë shqyrtimit të ankesës Bashkia Kavajë, pranoi se nuk ka përmbushur detyrimet ligjore sipas parashikimeve në fuqi, në lidhje me parkimin e dedikuar për personat me aftësi të kufizuara në territorin e administruar nga ana e saj.

Garantimi i aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, sikurse më sipër rezulton, kërkon aplikimin e një sërë standardesh dhe kriteresh teknike, të cilat janë miratuar me VKM nr. 1503/2008. Është respektimi në tërësinë e tyre, i këtyre standardeve dhe kriterëve teknike që mundëson heqjen e barrierave/pengesave për personat me aftësi të kufizuara dhe mundëson që personat me aftësi të kufizuara të kenë akses dhe të përfitojnë në baza të barabarta me të tjerët shfrytëzimin e hapësirave publike të Bashkisë Kavajë. Ekzistenca e pengesave/barrierave infrastrukturore në hapësirat publike të Bashkisë, sjell si pasojë që personave me aftësi të kufizuara t'ju mohohet akses për të marrë shërbimet e ofruara.

Referuar nenit 23, të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Bashkia Kavajë është përgjegjëse dhe për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të shesheve publike vendore. Nëpërmjet ndërtimit dhe rehabilitimit të infrastrukturës rrugore, Bashkia Kavajë mund të sigurojë kushtet e nevojshme dhe të domosdoshme që personat me aftësi të kufizuara të kenë një jetesë të pavarur dhe të marrin pjesë plotësisht në të gjitha aspektet e jetës.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, Bashkia Kavajë nuk ka të parashikuara/vendosura në territorin e saj, parkime për personat me aftësi të kufizuara, e për rrjedhojë Bashkia Kavajë nuk ka përmbushur detyrimet ligjore në fuqi në lidhje me sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara. Meqenëse aksesueshmëria, është një parakusht që personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në baza të barabarta me të tjerët në shoqëri, për të jetuar në mënyrë të pavarur, Komisioneri vlerëson se mospërmbushja e standardeve teknike të miratuara me qëllim sigurimin e aksesueshmërisë, i ekspozon personat me aftësi të kufizuara ndaj një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm dhe në rastin konkret në raport me banorët e tjerë të Bashkisë Kavajë.

B. Shkaku i mbrojtur.

Pala ankuese pretendon diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuara nga ana e Bashkisë Kavajë, për shkak të mungesës së vendeve të parkimit në territorin e bashkisë, për personat me aftësi të kufizuara.

Në nenin 1, të LMD, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuara, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Referuar nenit 1, të LMD, shkak i diskriminimit “*aftësia e kufizuar*” i pretenduar nga pala ankuese, konsiderohet si shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në LMD.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë më pak të favorshëm me shkakun e mbrojtur.

Parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: “*Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllajta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta*”, si dhe “*Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përliqet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë.*” (shih vendimet nr. 39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, të Gjykatës Kushtetuese)

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, duke mos parashikuar një të drejtë të veçantë në lidhje me aksesueshmërinë, ndërkohë që Protokollin 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.

Gjithashtu, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet¹⁰. Sipas GJEDNJ-së, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çenohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve është objektivisht e ndryshme¹¹. GJEDNJ, shprehet se, ndalimi që rrjedh nga neni 14 do të krijojë detyrime pozitive për shtetet kontraktuese për të bërë dallimet e nevojshme ndërmjet personave ose grupeve, rrethanat e të cilëve janë në mënyrë të rëndësishme dhe domethënëse të ndryshme¹². Për më tepër, GJEDNJ, shprehet se, neni 14 nuk e ndalon një shtet anëtar që t'i trajtojë grupet

¹⁰ Shih: *Molla kundër Greqisë*, Vendim i Dhomës së Madhe, 2018, prg. 135; *Fabián kundër Hungarisë*, Vendim i Dhomës së Madhe 2017, prg. 113; *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1985, prg.72.

¹¹ Shih: *Çështja Thlimmenos kundër Greqisë* [GC], nr. 34369/97, prg. 44, GJEDNJ 2000-IV; *Çështja J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24 tetor 2019.

¹² Shih: *Çështja J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24 tetor 2019.

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

ndryshe për të korigjuar “pabarazitë faktike” ndërmjet tyre; në të vërtetë, në rrethana të caktuara, dështimi në përpjekje për të korigjuar pabarazinë nëpërmjet trajtimit të ndryshëm, mund të shkaktojë në vetvete një shkelje të nenit 14¹³.

KDPAK parashikon në nenin 9, të saj të drejtën për aksesueshmëri si një të drejtë më vete, përpos parashikimit të aksesueshmërisë si një nga parimet mbi bazën e të cilit duhet të interpretohen të gjithë të drejtat e tjera për personat me aftësi të kufizuara. KDPAK ndalon gjithashtu çdo formë diskriminimi me bazë aftësinë e kufizuar.

Sipas nenit 3, pika 1 të LMD, të ndryshuar, “diskriminimi” përkufizohet si: *çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.*

Në pikën 1, të nenit 5, të LMD, sanksionohet se ndalimi i diskriminimit, sipas formulimit vijues: *“1. Ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.”*

Në kreun IV, të LMD, parashikohet një mbrojtje të posaçme nga diskriminimi në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve. Konkretisht, në nenin 20, pika 1, të LMD parashikohet: *“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato:*

- a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;*
- b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi”.*

Parashikimet e bëra në pikën 2, të nenit 20, të LMD, janë orientuese dhe jo shteruese. Referuar funksioneve të Bashkisë Kavajë në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike dhe përgjegjësisë së bashkisë në ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore, të trotuareve dhe shesheve publike, janë të mira që ofrohen për publikun në përgjithësi dhe janë të mira të cilat hyjnë në fushën e veprimit të nenit 20, të LMD-së.

Në bazë të LMD, jo çdo diferencë në trajtim, konsiderohet diskriminim. Në bazë të nenit 6, të LMD, përcaktohet se: *“Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivist të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të*

¹³ Shih: Çështjen *Horváth dhe Kiss kundër Hungarisë*, nr. 11146/11, datë 29.01.2013, prg. 101; Çështjen *Thlimmenos*, cituar më lart, prg. 44; Çështjen *D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* (GC), nr.57325/00, GJEDNJ 2007-IV, prg.175).

marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”.

Barra e provës në çështjet e diskriminimit, është objekt i rregullimit të veçantë sipas LMD-së. Bazuar në nenin 33 pika 7/1, të LMD, sanksionohet se: *“Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim”.*

Të njëjtin rregullim, në lidhje me barrën e provës parashikohet edhe nga Kodi i Procedurave Administrative. Konkretisht, në nenin 82, pika 2 të Kodit përcaktohet se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.*

Sa më sipër, pala ankuese duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjekti që pretendohet se ka kryer diskriminimin, i cili duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
2. Ose duke provuar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njërën nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjëse për diskriminimin.¹⁴

Në aspektin procedural, si fillim pala ankuese duhet të provojë se i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e diferencuar, është shkakun i mbrojtur nga diskriminimi, dhe në kushtet kur arrihet ky nivel provueshmërie barra e provës për të provuar të kundërtën, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i bie palës tjetër. Pra, nëse faktet e prezantuara nga pala ankuese duken të besueshme dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ në praktikën e vet i ka pranuar ato si të provuara, përveçse kur pala tjetër kundër së cilës paraqitet ankesa paraqet një shpjegim alternativ bindës.

Për sa i përket pyetjes se çfarë e bën një provë *prima facie* të aftë për të zhvendosur barrën e provës tek subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa, Komisioneri do të mbështetet në parimet e përgjithshme që dalin nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së. Në çështjen *Baka kundër Hungarisë* (DHM) (nr. 20261/12, paragrafi 143, datë 23 qershor 2016), GJEDNJ shprehet se: *“Në veçanti, Gjykata miraton konkluzione që, sipas saj, mbështeten nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave, duke përfshirë konkluzionet e tilla që mund të rrjedhin nga faktet dhe*

¹⁴ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

parashtrerasat e palëve. Prova mund të rrjedhë nga bashkëjetesa e konkluzioneve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme ose të prezumimeve të ngjashme faktesh të pakundërshtueshme¹⁵”.

Komisioneri çmon të nevojshme të theksojë se, është pikërisht bazuar në standardin e mësipërm të të provuarit, që do të shqyrtojë dhe do të konkludojë në lidhje me bazueshmërinë e pretendimeve për diskriminim të parashtruara në këtë ankesë.

Bazuar në faktet dhe provat e administruara si dhe detyrimet që burojnë nga legjislacioni në fuqi, rezultoi e provuar se Bashkia Kavajë, nuk përmbush standardet e miratuara për sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, në lidhje me garantimin e parkimit të dedikuar për personat me aftësi të kufizuara. Dështimi për të përmbushur standardet teknike të miratuara me qëllim sigurimin e aksesueshmërisë, i ekspozon personat me aftësi të kufizuara ndaj një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm dhe në rastin konkret në raport me personat e tjerë. Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se grupi i personave me aftësi të kufizuara, trajtohen në mënyrë më pak të favorshme për shkak se mospërmbushja e standardeve teknike i vendos ata përpara pengesave dhe barrierave, në raport me pjesën tjetër të personave që nuk kanë aftësi të kufizuara, të cilët nuk përballen me barriera/pengesa sikundër personat me aftësi të kufizuara.

Sa më sipër, rezulton plotësisht e provuar lidhja shkakësore midis shkakut të mbrojtur që në rastin konkret është aftësia e kufizuar dhe trajtimit të pafavorshëm dhe të pabarabartë të cilit i janë nënshkruar personat me aftësi të kufizuara, për shkak të mosrespektimit të standardeve të aksesueshmërisë të miratuar nga aktet në fuqi, si më sipër janë cituar.

Komisioneri vlerëson se, bazuar në faktet dhe provat e administruara, jemi në kushtet kur mund të prezumohet se ka patur diskriminim, pra të diskriminimit *prima facie*. Rrjedhimisht, bazuar në standardin e provës, Bashkia Kavajë kishte barrën e provës që të provonte se trajtimi i pabarabartë dhe më pak i favorshëm të cilit i janë nënshkruar personat me aftësi të kufizuara në Bashkinë Kavajë, ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm.

Aksesueshmëria është një parakusht për gëzimin efektiv të të drejtave të ndryshme nga personat me aftësi të kufizuara, përfshi edhe të drejtën për arsim. Megjithatë sipas KDPAK, sigurimi i aksesueshmërisë arrihet përmes realizimit progresiv.

Referuar Komentit të Përgjithshëm Nr. 2 (2014), mbi nenin 9 “Aksesueshmëria”, të miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, parashikohet se: “E drejta për aksesueshmëri për personat me aftësi të kufizuara sigurohet përmes zbatimit të rreptë të standardeve të aksesueshmërisë. Pengesat për të hyrë në objektet ekzistuese, ambientet, mallrat dhe shërbimet e synuara ose të hapura për publikun duhet të hiqen gradualisht në një mënyrë sistematike dhe, më e rëndësishmja, të monitoruar vazhdimisht, me qëllim që të sigurohet aksesueshmëria e plotë”.

¹⁵ Shih: GJEDNJ- Baka kundër Hungarisë (DHM), nr. 20261/12, paragrafi 143, 23 qershor 2016.

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

Kjo qasje parashikohet edhe në nenin 4, të ligjit nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, në bazë të të cilit është miratuar VKM nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”. Në këtë VKM, parashikohet se planifikimi për realizimin e përshtatjes, nga ana e subjekteve të detyruara, do të realizohet në mënyrë progresive (Kreu I, pika 12).

Sipas pikës 10, të kreut I, të VKM-së, parashikohet gjithashtu se: “Në planin e masave përfshihet detyrimi i subjektit për: a) evidentimin e objekteve ekzistuese dhe të shërbimeve, për të cilat nevojitet përshtatshmëria; b) planifikimin progresiv të fondeve të nevojshme për përshtatjen; c) përcaktimin e afatit kohor për realizimin e përshtatshmërisë”.

Vendimi nr. 1074/2015 vijon më tej duke parashikuar në Kreun I, pikat 9, 10, 13 dhe 14 të tij se: “9. Çdo subjekt, që ofron shërbime për publikun, është i detyruar që të miratojë një plan masash për zbatimin e kërkesave të këtij vendimi brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja e tij në fuqi. 10. Në planin e masave përfshihet detyrimi i subjektit për: a) evidentimin e objekteve ekzistuese dhe të shërbimeve, për të cilat nevojitet përshtatshmëria; b) planifikimin progresiv të fondeve të nevojshme për përshtatjen; c) përcaktimin e afatit kohor për realizimin e përshtatshmërisë. 13. Çdo subjekt, sipas pikës 4, të këtij vendimi, ka detyrimin që, brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve nga data e miratimit të planit të masave, të fillojë punën për të realizuar procesin e përshtatshmërisë lidhur me objektet ekzistuese dhe shërbimet e ofruara”.

Realizimi progresiv do të thotë se heqja e pengesave dhe sigurimi i aksesueshmërisë duhet të sigurohet në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike, por në çdo rast në mënyrë të qëndrueshme, efektive dhe brenda një kornize afatshkurtër dhe afatmesme.

Gjatë shqyrtimit të çështjes në fjalë, Bashkia Kavajë, parashtrori se kishte filluar procedurat për tenderimin mbi sinjalistikën rrugore të qytetit të Kavajës, si dhe të sinjalistikën e vendparkimeve për personat me aftësi të kufizuara, të cilat do të vendoseshin në rrugët dhe sheshet ku është i mundur parkimi i automjeteve.

Në këtë kuptim, Bashkia Kavajë deri në momentin e paraqitjes së ankesës pranë Komisionerit, pranoi se nuk ka marrë masa për garantimin e hapësirave të parkimit/vendparkimit për personat me aftësi të kufizuara sipas kërkesave të parashikuara nga Vendimi Nr. 1503, datë 19.11.2008 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara” (në vijim VKM nr. 1503/2008).

Pavarësisht faktit që nga ana e saj, Bashkia Kavajë informoi dhe nisi procedurat për tenderimin mbi sinjalistikën rrugore të qytetit të Kavajës, si dhe sinjalistikën e vendparkimeve për personat me aftësi të kufizuara, nuk vuri në vijim asnjë informacion lidhur me përfundimin e punimeve apo plotësimin e kërkesave të subjektit ankues edhe pse nga Komisioneri iu kërkua në mënyrë të përsëritur.

Bashkia Kavajë, është autoriteti që në bazë të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ka detyrimin që të sigurojë vendet e parkimit për personat me aftësi të kufizuara dhe

sipas standardeve ligjore të miratuara. Për të gjitha të mirat apo shërbimet për të cilat Bashkia Kavajë ka përgjegjësinë për t'i ofruar në juridiksionin e saj, kjo bashki, është gjithashtu përgjegjëse që, cilido subjekt apo njësi zbatuese në territorin e administruar prej saj të veprojë sipas kërkesave ligjore apo që produktet, shërbimet apo investimet ku përfitues apo përgjegjësinë ligjore për ofrimin e tyre është Bashkia Kavajë, të jenë në përputhje me parashikimet ligjore.

Në kuadër të procedurës së shqyrtimit të ankesës, në të cilën Bashkia Kavajë është në cilësinë e palës kundër të cilës është paraqitur ankesa, kishte detyrimin që të depozitonte pranë Komisionerit të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për të treguar se sjellja e saj është në përputhje me kërkesat ligjore. Gjatë shqyrtimit të ankesës, Bashkia Kavajë, nuk depozitoi asnjë provë për të treguar se nga ana e saj, pavarësisht mospërbushjes së detyrimit ligjor për të garantuar vendet e parkimit të rezervuar për personat me aftësi të kufizuara në të gjithë territorin e administruar prej saj, kishte marrë masa konkrete për të siguruar aksesueshmërinë në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike, por në çdo rast në mënyrë të qëndrueshme, efektive dhe brenda një kornize afatshkurtër dhe afatmesme, nëpërmjet hartimit të një plani me parashikime konkrete të burimeve financiare dhe afateve kohore për sigurimin e vendeve të parkimit për personat me aftësi të kufizuara.

Mangësitë në realizimin e aksesueshmërisë në shërbime për personat me aftësi të kufizuara, janë evidentuar dhe në Planin Kombëtar për PAK 2021-2025, ku në pikën 3.1.1 *“Aksesueshmëria fizike”*, përshkruhet se: *“Rol dhe përgjegjësi të madhe në realizimin e aksesueshmërisë fizike kanë pushteti vendor. Nga ana e bashkive ka një mungesë të theksuar të zbatimit të VKM-së nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”*.

Nga faktet dhe provat e administruara rezultoi se Bashkia Kavajë nuk ka marrë masa për hartimin e një plani masash për të identifikuar dhe planifikuar përmbushjen e standardeve të aksesueshmërisë në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike, sikurse kërkohet nga VKM nr. 1074, datë 23.12.2015 *“Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”*.

Në mungesë të dokumentacionit provues në lidhje me hapat konkretë të ndërmarrë për të realizuar aksesueshmërinë, Komisioneri arrin në përfundimin se Bashkia Kavajë nuk ka marrë asnjë masë për të planifikuar dhe realizuar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara.

Për të siguruar aksesueshmërinë, KDPAK kërkon miratimin e disa standardeve minimale që duhet të përmbushen, standarde këto që rezultojnë të jenë miratuar, sikundër është parashtruar edhe më sipër në këtë vendim.

Referuar Komentit të Përgjithshëm nr. 2 (2014), mbi nenin 9 *“Aksesueshmëria”*, të miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, si autoriteti përgjegjës i ngarkuar nga KDPAK për interpretimin e kësaj Konvente, parashikohet se: *“31. Si minimum, situatat e mëposhtme në të cilat mungesa e aksesit ka penguar një person me aftësi të kufizuara të ketë akses në një shërbim ose objekt të hapur për publikun, duhet të konsiderohen si akte të ndaluara*

të diskriminimit të bazuar në aftësinë e kufizuar: (a) kur shërbimi ose objekti është krijuar pas miratimit të standardeve përkatëse të aksesueshmërisë.....”

Komisioneri konstaton se, Bashkia Kavajë, në mënyrë të pajustificuar, nuk ka ndërmarrë masa për heqjen e pengesave dhe sigurimin e aksesueshmërisë në mënyrë efektive, brenda afateve kohore të arsyeshme, pavarësisht miratimit të standardeve teknike¹⁶ që prej vitit 2008 dhe detyrimit për të marrë masa për të identifikuar dhe planifikuar në mënyrë progresive dhe efektive eliminimin e pengesave/barrierave në territorin e administruar prej saj.

Referuar Komentit të Përgjithshëm Nr.2 (2014), mbi nenin 9 “Aksesueshmëria”, të miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, parashikohet se:

“.....25. Aksesueshmëria lidhet me grupet, ndërsa përshtatja e arsyeshme lidhet me individët. Kjo do të thotë se detyra për të ofruar akses është një detyrë ex ante. Prandaj, shtetet palë kanë për detyrë të ofrojnë aksesueshmërinë përpara se të marrin kërkesa individuale për të hyrë ose përdorur një vend ose shërbim..... Standardet e aksesueshmërisë duhet të jenë të gjera dhe të standardizuara..... Në përputhje me Konventën, shtetet palë nuk lejohen të përdorin masat shtrënguese si justifikim për të shmangur sigurimin e aksesueshmërisë graduale për personat me aftësi të kufizuara. Detyrimi për të zbatuar aksesueshmërinë është i pakushtëzuar, pra subjekti i detyruar që të sigurojë aksesueshmërinë nuk mund të justifikojë mosveprimin për t'a siguruar atë, duke iu referuar barrës për sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara. Detyrimi për përshtatjen e arsyeshme, përkundrazi, ekziston vetëm nëse zbatimi nuk përbën barrë të tepruar për subjektin.

26. Detyra për të ofruar përshtatje të arsyeshme është një detyrë ex nunc, që do të thotë se është e detyrueshme që nga momenti kur një individ me dëmtim ka nevojë për të në një situatë të caktuar..... Këtu, standardet e aksesueshmërisë mund të jenë një tregues, por mund të mos merren si urdhërues. Përshtatja e arsyeshme mund të përdoret si një mjet për të siguruar akses për një person me aftësi të kufizuara në një situatë të caktuar.....”

GJEDNJ në jurisprudencën e saj, lidhur me diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara, ka mbajtur qëndrimin se: *“duke pasur parasysh nevojën për të parandaluar diskriminimin ndaj personave me aftësi të kufizuara dhe për të nxitur pjesëmarrjen dhe integrimin e tyre të plotë në shoqëri, marzhi i vlerësimit që gëzojnë shtetet në vendosjen e trajtimit të ndryshëm ligjor për personat me aftësi të kufizuara është ndjeshëm i reduktuar¹⁷ dhe se për shkak të cenueshmërisë së veçantë të personave me aftësi të kufizuara, një trajtim i tillë do të kërkonte arsye shumë të rëndësishme për t'u justifikuar¹⁸”*.

Komisioneri arrin në përfundimin se, mosplotësimi i standardeve të aksesueshmërisë në lidhje me sigurimin e parkimeve të rezervuara për personat me aftësi të kufizuara në territorin e Bashkisë Kavajë, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuara, në raport me pjesën tjetër të personave që nuk kanë aftësi të kufizuara, të cilët nuk përballen me barriera/pengesa sikundër

¹⁶ VKM nr. 1503, datë 19.11.2008 “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me AK”.

¹⁷ Shih: *Glor kundër Zvicrës*, nr.13444/04, prg. 84, GJEDNJ 2009.

¹⁸ Shih: *Guberina kundër Kroacisë*, nr. 23682/13, 73, GJEDNJ 2016.

personat me aftësi të kufizuara. Bazuar në faktet dhe provat e administruara Komisioneri vlerëson se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, për mosveprimin nga ana e Bashkisë Kavajë dhe marrjen e masave për heqjen e barrierave/pengesave për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuar në territorin e Bashkisë Kavajë.

Në këto kushte, Komisioneri konstaton se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm të cilit i janë nënshtruar personat me aftësi të kufizuara. Për rrjedhojë Komisioneri arrin në përfundimin se trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm i personave me aftësi të kufizuara, përbën diskriminim sipas parashikimeve të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Bazuar në nenin 33, pika 10 të LMD, përcaktohet se: “Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre”, ndërsa bazuar në nenin 33, pika 12, të lmd, përcaktohet: “Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës”.

LMD, në nenin 33/10 të tij, nuk ka përcaktuar masat që duhen marrë për rregullimin e situatës diskriminuese, por e ka lënë në diskrecionin e Komisionerit. Pra, Komisioneri rast pas rasti, vendos se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të personave që pretendojnë se janë viktima të diskriminimit. LMD, nëpërmjet nenit 33/12, ka vendosur kriteret që duhet të ndjekë Komisioneri në përcaktimin e masës që ai jep nëpërmjet vendimeve të tij.

Komisioneri ka konstatuar sjellje diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuara, pasi rezultoi se Bashkia Kavajë nuk kishte marrë masa për të siguruar standardet teknike të aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara. Për rrjedhojë edhe masa rregulluese duhet të jetë në funksion të rregullimit të situatës së diskriminimit. Komisioneri vlerëson se masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese duhet të jetë plotësimi nga ana e Bashkisë Kavajë, i standardeve teknike të aksesueshmërisë në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi në lidhje me garantimin e vendparkimeve të rezervuara për personat me aftësi të kufizuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara, nga ana e Bashkisë Kavajë, në lidhje me garantimin e parkimeve të personave me aftësi të kufizuar në territorin e bashkisë.

2. Bashkia Kavajë të marrë masa për hartimin e një plani të detajuar për parkimet publike për personat me aftësi të kufizuara në territorin e saj. Pjesë e planit të masave duhet të jetë planifikimi progresiv i fondeve të nevojshme për përshtatjen dhe përcaktimi i afateve kohore për sigurimin e parkimeve publike për personat me aftësi të kufizuara.
3. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Bashkia Kavajë, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Aftësia e kufizuar)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)